



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
Dep.	AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
Dep.	ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep.	
Nr. ifaq.	DPKI
Broj stranica	02
Nr. page	
Nº Prot.	
Br. Prot.	
Prot No.	
06-02-2662/22	
Date	
Datum 24.06.2022	
Dated	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nëparag. 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nëparag. 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit, me datë 24.06.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbylllet rasti AKK-DPKI-06-2601/21, për zyrtarin e lartë z. Shemsedin Dreshaj, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak se ështëshmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Shemsedin Dreshaj, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi që është identifikuar se zyrtari i lartë z. Shemsedin Dreshaj, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, njëkohësisht është edhe person i autorizuar në biznesin privat "Shemsedin Dreshaj" B.I. (emri tregtar: O.S "Shëndeti - Sh").

Agjencia kundër Korruptionit, me qëllim të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesit ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) informata për biznesin në fjalë. Nga informata për biznesin e pranuar prej ARBK-së (DPKI-06-2601/21), është konstatuar se zyrtari i lartë në fjalë, është person i autorizuar në biznesin e sipërshënuar.

Agjencia kundër Korruptionit, me shkresën zyrtare DPKI-06-02/2170/22, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, z. Shemsedin Dreshaj është njoftuar lidhur me faktet për rastin e tij, si dhe është udhëzuar për veprimet që duhet t'i ndërmerr për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionin publik.



Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë përfaqësues i autorizuar në biznes privat, për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohet me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të LPKI-së, ku përcaktohet se:

"Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë private, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritet tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni".

Zyrtari i lartë z. Shemsedin Dreshaj, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë kundër Korruptionit dhe ka premtuar se menjëherë do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korruptionit ka pranuar informatën të cilën më pas e ka konfirmuar nga ARBK (DPKI-06-02/2170-1/22) se zyrtari i lartë ka bërë ndryshimet e nevojshme në biznes, duke bartur të drejtat e drejtimit të biznesit tek një person tjetër (personi i besuar).

Pas analizimit të informatës si më lartë, Agjencia kundër Korruptionit konstatoi se zyrtari i lartë z. Shemsedin Dreshaj, ka transferuar të drejtat e drejtimit të biznesit privat tek personi i besuar, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënpar. 1.1 lidhur me nenin 15 të I.PKI-së. Në këtë mënyrë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtari i lartë, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

